



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
GJEOGRAFI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_

VENDI \_\_\_\_\_

KOMUNA \_\_\_\_\_


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 412024121453

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

## UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps "shkruaj – fshij" nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR
<p>Tek detyra me një përgjigje të saktë</p> <p>Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.</p> <p><input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci</p>
<p>Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta</p> <p>Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.</p> <p><input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5</p>

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR  
TESTI  
GJEOGRAFI

1. Cili objekt paraqitet me shenjat hartografike të vijave?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- liqeni                       banja                       lumi                       manastiri
2. Cilit muaj ia japim një ditë më tepër në vitin e brishtë?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- marsit                       shkurtit                       gushtit                       nëntorit
3. Sa zgjat rotacioni i Tokës rreth boshtit të imagjinuar?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- 356 ditë                       30 ditë                       24 orë                       26 orë
4. Çka është dridhja e shkurtë dhe befasuere e korës së Tokës?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ndërrimi i baticës dhe zbaticës
- erupcioni vullkanik
- tërmeti
- denudimi
5. Sa është shtimi natyror në një vend, nëse nataliteti është 300, ndërsa mortaliteti 150?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- 150                       450                       300                       2
6. Në cilin brez të nxehtësisë jeton numri më i madh i popullsisë?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- në brezin e ftohtë verior
- në brezin e ftohtë jugor
- në brezin mesatar verior
- në brezin e nxehtë

7. Çka është Jastrebaci?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- lum                       liqe                       mal                       vendbanim
8. Cili det është pjesë e kufirit natyror mes Europës dhe Azisë?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- Deti i Kuq                       Deti i Bardhë                       Deti i Verdhë                       Deti i Zi
9. Cili oqean lag brigjet e Antarktikut?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- Oqeani Atlantik                       Oqeani Jugor                       Oqeani i Qetë                       Oqeani Indian
10. Cili kontinent me tërë sipërfaqen e tij, gjendet në hemisferën jugore dhe lindore të Tokës?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- Australia                       Antarktiku                       Afrika                       Amerika Jugore
11. Nëse pohimi është i saktë, ngjyros rrethin në kolonën SAKTË, nëse nuk është e saktë, ngjyros rrethin në kolonën e PASAKTË.

	SAKTË	PASAKTË
Rrjetin lumor e përbën lumi me të gjitha degët e saj.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Monsunet janë erëra periodike.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vendi në shkretëtirë me burim uji dhe vegjetacion quhet oazë.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

12. Çka nënkupton termi eksplozioni demografik?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- shtimi natyror negativ
- rritja e shpejtë e numrit të popullsisë
- rënia e shpejtë e numrit të popullsisë
- zgjatja e jetës

- 13.** Çka është UNESCO?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- lidhje ushtarake
  - organizata për arsim, shkencë dhe kulturë
  - bashkësia e shteteve e krijuar në vitin 1992 në Bruksel
  - organizata ndërkombëtare për ushqim dhe bujqësi
- 14.** Parku më i vjetër nacional gjendet në Srem. Mali sipas të cilit parku e ka marrë emrin është i njohur edhe si Mali i Shjenjtë Serb.  
Për cilin park Nacional është fjala?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- Parku Nacional Kopaoniku
  - Parku Nacional Tara
  - Parku Nacional Sharri
  - Parku Nacional Frushka Gora
- 15.** Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.  
Kënetat e Obedit është liqe lumor i krijuar me shkëputjen e meandrit të lumit:
- Tisës
  - Danubit
  - Begejit
  - Savës
- 16.** Ngjyros rrethin në fushën përkatëse, për të lidhur shtetet me pozitën e tyre në raport me detin.

	kontinental	gjysëmishullor	ishullor
Malta	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Austria	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Italia	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

17. Çka ka ndikuar në krijimin e shkretëtirës Gobi në Azinë Qendrore?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- aktiviteti intenziv njerëzor
- tropiku jugor i cili prenë Azinë Qendrore
- monsun i cili fryn në këtë territor
- izolimi i Azisë Qendrore dhe mungesa e reshjeve

18. Pse hapësira e rrafshlartës së liqeneve është dëndur e banuar?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Shumica e popullsisë afrikane jeton brigjeve të liqeneve.
- Në hapësirën e rrafshlartës së liqeneve nuk ka vullkane.
- Për shkak të rrjetit të dëndur lumor.
- Për shkak të kushteve klimatike.

19. Nëpërmes cilave male është e prerë lugina e Moravës Jugore?


Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- malet Ballkanike
- malet e Vllahit të Vjetër
- malet e masivit serbo-maqedonas
- malet e Kopaonikut

20. Çfarë forme të territorit ka shteti i shenjuar në fotografi?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- formë e ndarë e territorit
- formë kompakte e territorit
- formë e zgjatur e territorit
- formë e fragmentuar e territorit



# FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI

# GJEOGRAFI

## FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_

VENDI \_\_\_\_\_

KOMUNA \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR